

VENDIM
Nr.76, datë 2.2.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.781, DATË 29.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS
400 KV, TIRANË – PODGORICË, QARKU Durrës”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.781, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2159.4 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë katër) m², tokë bujqësore, shtëpi, arë dhe ullishte, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 11 980 921 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekësh.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi prej 11 980 921 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekësh, të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTESA E LISTËS SË PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS
SË TENSIONIT TË LARTË 400 KV TIRANË-PODGORICË, QARKU Durrës

Qarku: Durrës
Komuna: Nikël

Nr.	Objekti	Shpronësim definitiv									
		Emri	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr.i pasurisë	Sasia e sipërfaqes së pronës m ²	Çmimi shitje ZRPP lekë/m ²	Vlera e kompensimit	Adresa	Informacion
1	Linja 400kv	Asllan	Zaja	Shtëpi nën linjë	2737	942/6	165.2	36561	6,039,877	Nikël	ALUIZNI
2	Linja 400kv	Refat	Cangu	Shtëpi nën linjë	3783	239/18	103.5	36561	3,784,064	Nikël	Me certifikatë pronësie
									9 823 941		